




Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prilato Received/Delivered	31.12.2020	0	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednitsa Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHACK	3380/2020		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.364/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.364/2020 të datës 18.11.2020 e parashtruar përmes adresës elektronike nga ankuesi [REDACTED] me adresë rruga "Kalaja", Nr.44 në Komunën e Gjilanit, kundër organit të punësimit Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.364/2020 të datës 18.11.2020 e parashtruar përmes adresës elektronike nga ankuesi [REDACTED].

A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED] ka aplikuar në pozitë: "Zyrtar për Buxhet dhe Financa 1", të shpallur me datë 30.06.2020 nga Komuna e Gjilanit me nr. Ref.RN00006013, në bazë të autorizimit të datës 26.06.2020 të lëshuar nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike, për shpalljen e konkursit të jashtëm, nga data 30.06.2020 deri me 14.07.2020.

Komuna e Gjilanit me datë 28.09.2020, ka njoftuar të gjithë kandidatët se së shpejti do të fillojë procedura e rekrutimit për kandidatet që do të përfshihen në listën e shkurtër, për pozitat që kanë aplikuar. Me datë 27.10.2020 janë njoftuar kandidatet për listën e ngushtë për t'ju nënshtruar testimit me shkrim, ku ankuesi me datë 29.10.2020 ka marrë pjesë në testim me shkrim dhe ka arritur gjithsejtë 46 pikë, më datë 16.11.2020, ankuesi është njoftuar se nuk ka arritur pikët e mjaftueshme për t'ju nënshtruar intervistës me gojë.

Ankuesi i pa kënaqur me njoftimin e datës 16.11.2020, për shkak të mos arritjes se pikëve të mjaftueshmetë të testimit me shkrim për t'ju nënshtruar intervistës me gojë, ka parashtruar ankesë me datë 16.11.2020 tek Komisioni Përzgjedhës, në pajtim me Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, të cili ka dhënë përgjigje në ankesë me datë 30.11.2020 me nr. Protokolli016-107300/2.

Ankuesi [REDAKTUAR] pas përfundimit të procedurës së rekrutimit për pozitën: "Zyrat për Buxhet dhe Financa 1", me datë 18.11.2020 ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes adreses elektronike E-mailit, me pretendimet ankimore se komisioni përzgjedhës nuk ka arrit të vleresoj real për përgatitjen profesionale (CV) dhe pikët e testit me shkrim si dhe certifikatat e fushës përkatëse.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.11.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjilanit. Këshilli me datë 11.12.2020 ka pranuar dokumentacionin e bashkangjitur nga Komuna e Gjilanit, lidhur me ankesën e ankuesit prej 1/86 faqe.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën Anr.364/2020 me numër protokolli 2636/2020 të datës 18.11.2020 e parashtruar nga ankuesi [REDAKTUAR] në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emaili në adresë elektronike drejtuar KPMSHCK-së i datës 18.11.2020; Konkursi i datës 30.06.2020; Diplomë Universitare e datës 16.01.2018; Autorizim nga ASK e datës 17.07.2019; Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 03.06.2019; Kontratë e puës e datës 01.12.2010; Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 03.11.2017; Vërtetim i datës 07.01.2019; Certifikata; Kontrat për punë praktike e datës 17.06.2014; Kontrat për punë praktike e datës 14.07.2014; Përgjigje në ankesë e datës 11.12.2020 nr. Protokolli 3095/2020; Kërkesë pëunësim e datës 03.07.2020; Certifikat e notave e datës 3.06.2017; Paqyra e trustit pensionar nga data 01.08.2002 deri me datë 03.03.2020; Certifikat e datës 01.07.2020; Konfirmimi i datës 26.06.2020 lidhur me buxhetin e Komunës së Gjilanit; Autorizimi i datës 26.06.2020 me pershkrim të detyrave të punës; Vendimi nr.576 datës 10.07.2020; Regjistrimi i aplikacioneve i datës 14.07.2020; Raport i listës së shkurtër i datës 16.07.2020; Njoftimi i datës 28.09.2020; Njoftimi i datës 27.10.2020; Raporti i datës 02.11.2020; Ankese e datës 16.11.2020; Testi për aplikantin me kod-CN5125, nga SIMBNJ; Formular për CV-zyrtar për buxhet dhe financa 1; Email i datës 16.11.2020; Raporti i datës 02.11.2020 nga komisionit për zgjedhës; Përgjigje në ankesë e datës 30.11.2020; E-mail i datës 08.12.2020 për përgjigje në ankesë në formë elektronike; Prova shtesë të datës 21.12.2020 (E-mail), Njoftimi përfundimtar nga intervista me gojë e datës 17.11.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [REDAKTUAR], është e palejuar sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi i pa kënaqur me njoftimin e datës 16.11.2020, për shkak të mos arritjes se pikëve të mjaftueshme të testit me shkrim për t'ju nënshtruar intervistës me gojë, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në

Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.11.2020 ka parashtruar ankesë tek Komisioni Përzgjedhës. Në bazë të nenit 25 paragrafit 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimit dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, parashihet që: *"Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj..."*, ndërsa ankuesit më datë 18.11.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pa kaluar afati për shqyrtim të ankesës nga Komisioni i Pranimit siç parashihet me dispozitën e lartcekur.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, mbi bazë të kësaj konstaton se ankuesi ka qenë i obliguar që të presë afatin ligjor për shqyrtimin e ankesës nga Komisioni i Pranimit, e pastaj varësisht nga vendimi i Komisionit të Pranimit të parashtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës siç parashihet me nenin 31 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimit dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës i cili përcakton se: *Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli"). Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet"*, mbi bazë të kësaj ankesa e datës 18.11.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e pa lejuar, rrjedhimisht në pajtim me dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vendosi që ankesa e parashtruar nga ankuesi të hedhet poshtë si e pa lejuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.364/2020

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunë Gjilanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

Eshref SHABANI
Kryetar i Kolegjit